

**Permbledhje e shkurter e aktivitetit Prodhim Inerte, prodhim betoni e Shoqerise
"Kelliçi-2009" SHPK.**

Subjekti: Shoqeria "Kelliçi-2009" SHPK
Aktiviteti: Prodhim Inerte, prodhim betoni
Adresa : Tirane Helmes HELMES Helmes, Shtodher, objekt 1 katesh,
zone kadastrale nr 3427, nr pasurie 44/9.
Administrator: Altin Këlliçi
Cel: 0692096767, 0697700370



HYRJE

Emri i subjekti ne fjale "**Kelliçi-2009**" SHPK dhe numri i identifikimit te subjektit NIPT - i **K12512808S** i regjistruar me date **24/04/2001** me seli ne Tiranë Kavaje .

Objekti eshte "**Prodhim inerte**" i perket firmes "**Kelliçi-2009**" SHPK me perfaqshues ligjor **Altin Kelliçi**. Objekti ndodhet ne buze te superstrades Plepa - Rrogozhine 50 m larg perroit te Darcit. godine I kateshe.

Ky pozicion favorizon mundesine e manovrimeve funksionale te mjeteve qe kalojne ne kete superstrate dhe qe kane nevojte per furnizim me inerte. Sheshi ploteson kerkesat urbanistike per nje distenacion te tille dhe ndikon me se miri ne gjallerimin e superstruktures perkatese. **Tel. 0692096767, 0697700370**

Shoqeria "**Kelliçi-2009**" SHPK eshte nje subjekt i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e saj ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushen e prodhimit te produkteve te betonit si edhe punime

te ndryshme per objekte civile. Qellimi i firmes ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e saj.

Per kete qellim, subjekti "**KELLIÇI-2009**" SHPK referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" ka plotësuar Formularit e Kërkeses per tu pajisur me Leje Mjedisit te Tipit B per aktivitetin Impiant per prodhimin inerteve e produkteve te betonit, **Tirane Helmes HELMES Helmes, Shtodher, objekt 1 katesh, zone kadastrale nr 3427, nr pasurie 44/9**, Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti. Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti është të prodhoje Inerte, me kapacitet 50m³/dite, prodhim betoni me kapacitet 50m³/dite. Zbatimi i veprave ndertimore t për perballimin e kerkesave te sektorit te ndertimit, infrastruktures, industrise etj.

Aktiviteti zhvillohet ne nje ambjent te pershtatshem per kete aktivitet duke mos krijuar keshtu deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth.

Vendosja e impiantit te prodhimit te produkteve te betonit ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj.

Brenda sheshit jane te vendeosura:

- Impianti i prodhimit te produkteve te betonit;
- Mjediset e zyrave dhe ate higjenosanitare;
- Sheshi per depozitimin e fraksioneve te ndryshme.
- Sheshi per tharjen e produkteve prej betoni
- Sheshi per reklamimin e produkteve

Gjithashtu ne kete ambjent bejne pjese edhe hapesirat per levizjen e mjeteve, njerezve dhe siperfaqet e gjelbera, oborri i cili eshte i gjelberuar anash me bimesine karakteristike te ketyre ambienteve.

Mbi veprimtarine

Ne objekt behet larja dhe fraksionimi i inerteve te grupit te peste duke synuar plotesimin e nevojave te tregut vendas ne fushen e ndertimit. Teknologjia e instaluar per veprimtarine e mesiperme eshte ne parametra optimal. Kapaciteti prodhues eshte 50 m³ ne dite. Produkti qe prodhohet ne kantier eshte fraksionimi i inerteve. Materiali inert dote sigurohet nga lumi Shkumbin. Impianti eshte teper eficient persa i takon perdorimit te energjise. Linja teknologjike sipas proceseve qe realizon perbehet nga 6 njesi baze.

1. Bunkeri i depozitim it te inerteve eshte stacioni i pare i materialit i cili i nenshtrohet nje numri te caktuar procesesh. Ne bunker shkarkohet materialin inert i cili nepermjet forces terheqese gravitacionale drejtohet ne sistemin e pare te sitave.
2. Sistemi i pare i sitave eshte nje set sitash vibruese. Ketu realizohet nje ndarje fillestare grimcore e materialit inert bruto qe depozitohet ne bunker. Pjesa e fraksioneve qe depertojne ne kete system i perkasin fraksionit te reres i cili pastaj depozitohet ne vendin e caktuar ne shehin e kantierit.
3. Mulliri i coptimit dhe bluarjes se inerteve ku realizohet coptimi. Ne kazanin e mullirit.. eshte montuar nje system tubosh te cilet leshojne uje ne forme shiu. Copat shkojne ne rripin e transmisionit nr.2.

4. Transmesionikryesor i fraksioneve ted ala nga mulliri blures eshte rrip gome i cili realizon zhvendosjen ne njesine e sistemit te dyte te sitave.
5. Sistemi i sitave vibruese realizon klasifikimin perfundimtargranulometrik te fraksioneve te materialit inert qe coptohet ne mullirin e bluarjes. Ky system realizon ndarjen sipas fraksioneve dhe depozitimin e tij perfundimtame bunkerred e ngarkimit te automjeteve.
6. Njesia e bunkerave fundor te depozitimit perfundimtar te fraksioneve eshte agregati i fundit. Ne kete agregat i perbere nga 5 bunkere me kapacitet vellimor 20 m3 eshte realizuar perfundimisht procesi fraksionues i materialit inert.

Makineria e prodhimit te blloqeve

Pershkrim i pergjithshem

Makineria e prodhimit te bllokut vetelevizese BDA 100X100 eshte ndertuar per formimin e objekteve prej betoni te formave dhe dimensioneve te ndryshme ne varesi te kallepit te perdorur. Makineria eshte e perbere nga nje structure celiku ne te cilen jane vendosur te gjitha pjeset per funksionimin e akinerise, mekanizmat, impianti elektrik dhe hidraulik.

Betoni mbushet ne nje kove te pajisur me nje instrument qe na tregon nivelin minimal, mungesa e inerteve ndalon funksionimin automatic te makinerise. Betoni hiqet nga kova nga nje "sirtar" levizes, i cili eshte i pergjegjshem per mbushjen e kallepit, levizja ekzekutohet nga nje seri komandash te dhena ne menyre hidraulike. Para formimit te objektit (te betonit) makina pozicionon me ane te sistemit hidraulik nje pllake celiku nen kallep, pak milimetra toka. Pas mbushjes se kallepit me beton, nje sistem vibratoresh i aplikuar aty siguron nje mbushje ekselente te kallepit, ndersa nje sistem shtypes siguron kompaktesine e objektit.

Piedestrare (kembe) special antivibruese zvogelojne ndikimin e vibrimit tek makineria.

Pas mbarimit te formimit te objektit, makineria zhvendoset ose eshte e gatshme per fillimin e ciklit nga fillimi.

Zhvendosjet e mevonshme kryhen nga rrota e pozicionuar ne mes te dy rrotave te tjera, kjo rrote e lidhur me sistemin hidraulik lejon ngritjen e makinerise, duke liruar 2 rrotat e tjera, dhe keshtu mundesohet vazhdimi i ciklit te levizjeve te metejshme te makinerise.

Nje sonde e vendosur ne bazen e makinerise tregon per pranine e pengesave si p.sh (prezenca e objekteve prej betony te formuara me pare) dhe rivendos funksionimin normal te makines automatikisht nepermjet rrotes qendrore.

Makineria eshte e pajisur me dy mundesi operimi:

- Cikli automatik i punes
- Funksionimi manual

Gjate operimit ne ciklin automatic, makina eshte e kontrolluar nga programi kompjuterik elektronik PLC dhe i kontrollon te gjitha manovrat pa nderhyrjen e operatorit, i cili duhet vetem te mundesoje mbushjen e koves.

Ne funksionimin manual, operatori mund te ekzekutoje te gjitha manovrat e kerkuara me ane te komandave elektronike dhe hidraulike, te vendosura ne tryezen e komandave te makines.

- **Produktet kryesore te impiantit te prodhimit te betonit**

Kompania "KËLLIÇI-2009" SHPK ne linjen e vet te betonit prodhon tre produkte kryesore me prejardhje betoni. Seicili nga produktet ka perberje te cilesore te njejte, por ne varesi te receptures se lendeve te para prodhohen tre lloje kryesore produkti qe jane: Blloqe, Tuba dhe Bordura,etj

Prodhimi i ketyre produkteve kryesore te betonit behet ne baze te porosive apo kontratave qe kompania ka nga klientet e saj. Produktet e betonit trasportohen me kamiona te posatshem qe jane te mbuluar karrocerin per ne vendin ku perdoret.

- **Depozita e lendes se pare**

Ne impiantin e prodhimit te produkteve prej betoni, jane te instaluara depozita ku depozitohet lenda e pare (inerte dhe rere).

Depozitat jane te pajisura me transportier, i cili vendoset ne pune me ane te rrulave, duke bere te mundur peshimin dhe recepturen e inerteve.

- **Kova e perbashket**

Kova e perbashket e cila ndodhet e zhytur ne nje thellesi ku hidhet lenda e pare e pergatitur sipas receptures. Me ane te kavove, realizohet dergimi i lendes se pare nga depozitat e inerteve ne betoniere, ku dhe realizohet procesi i prodhimit te betonit.

- **Betoniere**

Betoniera eshte e ngritur nga toka ne nje lartesi, per te lejuar nje perzierje me te shpejte te pastes se betonit. Gjithashtu ajo eshte e pajisur dhe me nje zgare e cila eshte e arritshme me ane te shkalleve me qellim komandimin, kontrollin dhe sherbimin e saj ne rast avarie.

Betonierja rezlizon procesin e perzierjes se lendeve te para inerteve + reres + cemento + uje, sipas receptures se produktit te parafabrikuar qe eshte parashikuar te prodhohet.

Miksimi i lendeve te para realizohet nepermjet rrotullimin e thjeshte dhe dopio te lopatave te miksesit, te pajisura me shpatulla qe mbulojne te gjithë kazanin e betonieres duke realizuar nje perzierje te homogjenizuar te konglomerateve. Ne fund dhe ne faqet anesore te betonieres montohen unaza me perberje hekuri, duke rritur rezistencen e ferkimit te lopatave me kazanin e betonieres. Shkarkimi i betonit realizohet nepermjete pistonave hidraulik, te cilet bejne rrotullim e kazanit te betonieres.

- **Vibruesi i tubave**

Vibruesi i tubave sherben per te realizuar vibrimin e tubave te dimensioneve te ndryshme, me qellim arritjen e bashkimit grimcave te betoni duke hequr ajrin qe ndodhet brenda mases se prodhuar, duke ulur ne kete menyre porozitetin tubave, pra marrjen e produkti me rezistence me te larte.

- **Sillosi i cimentos**

Sillosi i cimentos sherben depozitim e lendes se pare cemento. Nga sillosi i cimentos me ane te nje elektromotori me thithje realizohet dergimi i cimentos per ne betoniere nepermjet nje tubi me gjatesi 8 m dhe diameter 20 cm, i cili realizon shkarkimin e cimentos ne peshore. Tubi i shkarkimit eshte i pajisur me nje valvur sigurie.

- **Procesi i prodhimit**

Per prodhimin e produkteve te betonit perdoret material lende e pare rere dhe granil. Rera dhe granili mbahen ne depozita te vecanta. Rera dhe granili del ne fund te depozites dhe me ane te transportierit te perbashket qe realizon peshimin dhe recepturen, me pas kalojne ne koven e perbashket, e cila e dergon materialin e perzier ne betoniere.

Nga sillosi i cimentos me ane te nje elektromotori me thithje realizohet dergimi i cimentos per ne betoniere nepermjet nje tubi me gjatesi 8 m dhe diameter 20 cm, i cili realizon shkarkimin e cimentos ne peshore. Tubi i shkarkimit eshte i pajisur me nje valvur sigurie.

Dergimi i ujit realizohet me anen e nje elektropompe te vogel, sipas kerkesave te receptures. Materiali (rere dhe granil) dhe cemento i futur ne betoniere perzihet, deri ne marrjen e receptures perfundimtare per prodhimin e produkteve prej betoni.

Pergatitja e receptures, peshimi i lendeve te para e deri ne perfitimin e produktit perfundimtar eshte nje proces i automatizuar qe kontrollohet nga puti i kontrollit ne kullen e kontrollit. Levizja e lendeve te para relaizohet nepermjet sistemve te mbullura ne menyre qe te shmangen krijimi i pluhrave nga aktiviteti i linjes se prodhimit te produkteve prej betoni .

Pamje nga proceset dhe impiantet e instaluara



- **Ndërtimi i linjës elektrike**

Në varësi të llojit të impiantit dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike. Aktualisht rrejtja e shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjendje mjaft të mirë dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Objekti, Magazina, Impianti prodhimit të produkteve të betonit në të gjitha ambjentet e tyre janë pajisur me kasete të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Menaxhimi i instalimit behet nga një staf i kualifikuar dhe trajnuar për të operuar dhe për të ushtruar aktivitetin e prodhimit të produkteve të parafabrikuara prej betoni, për të cilin shoqëria "**KËLLIÇI-2009**" SHPK operon në tregun rajonal. Për zhvillimin e aktivitetit të kësaj shoqëria konform të gjitha rregullave, teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore, është organizuar puna në mënyrë të tillë që të funksionojë në formën e një organogramme për realizimin sa më eficient dhe të suksesshem, e cila tregon mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësitë të secilit.

Pak a shumë hierarkia dhe rrjedhja e autoritetit tregohet në këtë skemë të thjeshtë ku çdo gjë varet drejtpërdrejt nga Administratori dhe nga aksioneri i vetëm i kompanisë.

Detyrat dhe Përgjegjësitë

- Hartimi dhe Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Mjedisit
- Menaxhimi i Prodhimit/Instalimit
- Sigurimi Teknik
- Hartimi dhe Zbatimi i Planit të Monitorimeve

- **Plani i menaxhimit të mjedisit**

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.

Kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtëse të përgjithshme. Duhet theksuar që menaxhimi mjedisor është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave. Duhet të zhvillohet një menaxhim mjedisor i detajuar dhe një program trajnimi.

Përbërësit kryesorë të këtij programi për menaxhimin e mjedisit do të ndërthuren si më poshtë:

- Informacion i përgjithshëm;
- Mirëkuptim i informacioni të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsytet për një menaxhim mjedisor të mirë;
- Përdorimi i pajisjeve/aparatura të Certifikuara sipas Standartit Europian dhe Kolaudimi
- periodik i pajisjeve/aparaturave nga ekspertë të specializuar.
- Respektimi i orareve të punës brenda zonës ku zhvillohet veprimtaria
- Respektimi i masave teknike të punonjësve, sipas rregullores së brendshme.
- Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga kompani të licënuara
- Zhurmat do të jenë të përkoshme dhe tepër të ulëta duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, sipas Udhëzimit Nr.8, dt 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.
- Mirëkuptimi i potencialit të ndikimeve ambientale, që mund të priten nga faza kryesore e zhvillimit të aktivitetit;
- Funksionimi;
- Arsytet për propozimin e masave zbutëse;
- Vendosja në zinxhir e përgjegjësive dhe vendim marrja;
- Trajnime specifike;
- Monitorimi i cilësisë ajrit;
- Kriteri për vendosjen e stacioneve monitoruese;
- Metodologjitë që duhen përdorur për fushën e marrjes së mostrave;
- Trajnime në përdorimin e pajisjes dhe teknikat korrekte për ruajtjen e mostrës;
- Trajnim në laborator dhe rëndësia e cilësisë së sigurisë dhe metodat e kontrollit të cilësisë;
- Trajnim në gjetjen e mospërputhjes së situatave dhe procedurat që duhen ndjekur;
- Kërkesat e mjeteve që do t’ju kryhet shërbimi;

Plani i Përballimit të Emergjencave

Shoqëria "KËLLIÇI-2009" SHPK në veprimtarinë e saj, për aktivitetin "Prodhimin e Produkteve të Betonit", detyrohet të planifikojë, të organizojë dhe të realizojë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimtaria.

Shoqëria ka për detyrë:

- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të njoftojë personelin si dhe autoritetet e bashkisë ose të komunës për një rrezik imediat.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjence në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

Emergjencat në këtë objekt, mund të vijnë nga këto shkaqe:

- **Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë**

Objekti është i ndërtuar me planimetri të rregullt dhe ka respektuar kriteret teknike për funksionimin normal të tijë. Ai ka sipërfaqe të mjaftueshme për kryerjen e proceseve të, operimit dhe funksionimit normal të instalimit, të lëvizjes së lirë të punonjësve, magazinimin e lëndës së parë, disponon hapësira të mjaftueshëm për parkim, për të përballuar fluksin e ngarkim-shkarkimit të produktit dhe të klientëve, etj. Sistemi i matjes e kontrollit të pajisjeve dhe instalimit, sinjaleve të alarmit dhe lëvizjeve të lëndës së parë në impiantin e prodhimit të produkteve prej betonit.

- Sistemi i matjes së kontrollit automatik të pajisjeve të makinerive, sinjalistikës si dhe të lëvizjes së lëndës së parë në impiantin e prodhimit të produkteve prej betonit, do të shërbejë për të ditur në çdo kohë gjendjen e instalimit gjatë proceseve që zhvillohen në impiant, si dhe sasinë e hyrjes dhe daljes së tyre, të cilat do të pasqyrohen në aparatet mates të kontrollit, që janë pjesë përbërëse e instalimit në panelin e kontrollit, e cila do të mbikqyret gjatë gjithë ciklit të punës. Aparaturat janë me sistem modern elektronik dhe të integruara në instalim.

- **Evakuimi i detyruar i njerëzve në rast zjarri**

Pozicioni i objekteve/instalimeve përbërëse të impiantit të prodhimit të produkteve të betonit, sipas destinacionit që ato kanë, është i tillë që jo vetëm respekton largësitë e mbrojtjes nga zjarri, por në rast zjarri është i zgjidhur edhe evakuimi i detyruar i njerëzve dhe mjeteve prej tyre.

- **Rënia nën tension**

Duke u nisur nga specifika që ka puna, është marrë në konsideratë edhe mbrojtja nga rënia nëntension e pajisjeve dhe e personelit që punon aty.

Dhe për këtë rast janë parshikuar veprimet e menjëhershme që do të kryhen.

- **Nga tërmetet**

Zona është e studiuar nga ana sizmike dhe bazamentet ku janë instaluar pajisjet dhe impianti, nuk përbëjnë rrezik për tërmetet. Kështu në rast tërmeti do të kishim vetëm lëkundje të tokës dhe nuk do të paraqesë rrezik për instalimin, objektet, personelin dhe për mjedisin përreth aktivitetit.

- **Nga përmytjet**

Sheshi i objektit ku është instaluar impianti, për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të produkteve të parafabrikuara prej betonit është i mbrojtur nga përmytjet.

Përreth objektit ekzistojnë kanale të mëdha drenazhuese për kullimin e ujrave të shiut.

- **Menaxhimi i prodhimit**

Për mbrojtjen e instalimit nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impiantit/makinerive nga papastërtitë e lëndës së pare, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj janë marre keto masa:

- Përreth impiantit të prodhimit të produkteve prej betoni ruhet distance e sigurisë prej 1.5 m, e cila është vizuar me vijë të verdhë, përgjatë këtij perimetri lëvizin vetëm drejtuesit teknik të impiantit dhe drejtuesi i panelit tekontrollit.
- Percaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën
- perkatese. Është instaluar sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelberim si dhe pozicioni që ato kanë) si dhe lagia me ujë e rrugicave të brendshme gjatë periudhës Maj-Tetor, ujrave të pastrimit do të shkarkohen në rrjetin e brendshëm të kullimit dhe nga aty në rrjetin e kryesor të kanalizimeve të zonës, këto ujra nuk janë të ndotura më lëndë me përbërje të rrezikshme.
- Brenda objektit kryhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat janë; lende të aballazheve,
- letra-kartona, qelqe, si dhe lende organike të prodhuara nga punonjësit ku këto mbetje depozitohen në vendin e caktuar nga Njësia Vendore ku janë vendosur kosha selektive. Mbetjet e ngurta urbane të prodhuara, depozitohen në kosha brenda territorit të shoqërisë me volum 1 m³ prej ku me pas merren nga mjetet e pastrimit të komunes, për të dërguar në venddepozitim dhe caktuar prej tyre. Sasia e mbetjeve urbane të gjeneruara nga punonjësit është 0.4kg/dite për person.
- Rrjeti elektrik që furnizon impiantin me energji elektike është i tokëzuar dhe i gjithë sistemi është i lidhur me kutinë qendrore të shpërndarjes e cila është e siguruar me celësin e sigurisë, për çfarëdo lloji avarie të mundshme.
- Lënda e pare (reres gurit, reres së lumit, granil 1, granil 2) transportohen me anën e transportierit, drejt koshit të përbashkët dhe nga aty drejt betonieres (miksuesi) së recepturës për perzierjen e inerteve. Furnizimi me lëndë të pare bëhet periodikisht, gjatë gjithë kohës së funksionimit të impiantit. Ndërsa për prodhimin e betonit lenda e pare hidhet në depozite dhe silloset e cimentos.
- Pajisjet e reja janë me të avancuara dhe një sërë veprimesh i kanë të automatizuara duke shmangur kështu nderhyrjen e punonjësve dhe të punuarit pranë tyre, për veç të tjerash shoqëria ka disa rregulla strikte të cilat zbatohen me rigorozitet për mos nderhyrjen në makineri gjatë punës, stakimit të energjisë para fillimit të kontrollit apo mirëmbajtjes e remontit të tyre, etj.
- Produkti përfundimtar me përberje betoni, sistemohet në sheshin para impiantit, ku dhe kryhet procesi i tharjes së produkteve për një kohë prej 7 ditësh dhe me pas bëhet ambalazhimi i blloqeve në paleta.

- **Sigurimi teknik në proçeset e punës**

Zbatimi i normave të rregullores së teknikës së sigurimit

Gjatë ushtrimit të aktivitetit për prodhimin e produkteve të betonit subjekti mban parasysh që problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë më të rëndësishmet dhe më të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

- Para se gjithash në të gjitha operacionet janë punësuar specialist me eksperience pune në kryerjen e proceseve të ndryshme të përdorimit të instalimit.
- Rregullore e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të drejtimit të operacioneve,
- zbatohet në çdo proces pune të përcaktuar në plan organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga ai dhe të miratuar nga drejtuesit e firmës.
- Plan organizimi i punimeve hartohet para fillimit të cdo operacioni të funksionimit të impiantit
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve
- Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar ben kontrollin teknik dhe azhornimin e saktë të punimeve të cdo lloji për të cilat subjekti është licensuar.
- Rradha e kryerjes së veprimeve përcaktohet hollesisht në planin e masave tekniko organizative dhe është i miratuar nga përfaqësuesi i shoqërisë.
- Në këtë plan tekniko-organizativ masat e teknikës së sigurimit zenë vendin kryesor.
- Drejtuesi teknik i punimeve kryen instruksione të rregullta mujore e tre mujore , ku trajtohen tema të vecanta për të gjitha profesionet dhe operacionet që zhvillohen brenda instalimit për prodhimin e produkteve të betonit.
- Kujdes i veçantë tregohet në krijimin e kushteve të punës , pastrimit të objektit dhe instalimit dhe monitorimit të parametrevë mjedisore, etj.
- Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit të zonës

- **Plani i Monitorimeve Mjedisore**

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve etj, kryhet sipas disa kritereve shkencore përsa i përket vrojtimit, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore. Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre. Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohe bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse. Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si AKM-ja, Ministria e Mjedisit, ISHMPU etj.

Masa për sigurimin teknik dhe mbrojtja në punë

Aktiviteti që zhvillon subjekti "**KËLLIÇI-2009**" SHPK praktikisht nuk përben rrezik për stafin (punonjësit) e tij, për arsye se investimet janë të koheve të fundit, me një instalim/paisje të reja e moderne, i gjithë procesi i punës është pothuajse i automatizuar cka e rrit sigurinë e impiantit. Impianti i prodhimit të

produkteve te betonit eshte nder me bashkohoret dhe nje sere veprimesh i kane te automatizuara duke shmangur keshtu nderhyrjen e punonjesve dhe te punuarit prane tyre, per vec te tjerash shoqeria ka disa rregulla strikte te cilat zbatohen me rigorozitet per mos nderhyrjen ne makineri gjate punes, stakimit te korentit para fillimit te kontrollit apo mirembajtjes e remontit te tyre, etj.

Detyrimet e punedhenesit:

Punedhnesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik qe ka te punesuar, duhet t'ju beje te ditur punemarresve:

1. Procesin e operacioneve ne teresi dhe te punes ne frontin ku punon.
2. Pajisjet dhe makinerite qe perdoren ne objekt dhe linjen e prodhimit te produkteve te betonit.
3. Shkaqet e aksidenteve dhe masat dhe per menjanimin e tyre.
4. Rregulloret e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune ne Republiken e Shqiperise, aktet ligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyre, te leshuara nga dikasteret qe lidhen me to.
5. Rregullat e sigurimit teknik qe lidhen me frontin e punes, makinerite dhe profesionin qe kryen sipermarresi si individ per mbrojtjen e vetes dhe punonjesve te tjere.
6. Rregullat e pergjithshme te sigurimit teknik ne impiante dhe sheshin e punes, per tu mbrojtur nga makinerite, rrymes elektrike, shkarkesat atmosferike, etj.
7. Ndhimen e pare shendetesore.
8. Instruktimi paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentohet sipas formalitetit te percaktuar ne rregulloren e sigurimit teknik.
9. Frontet e punes ne zbatimin e objektit, po te punohet naten duhet te ndriçohen me projektore qe furnizohen nga rrjeti elektrik ne menyre te pa varur nga ndriçimi individual i mjeteve motorike. Kur mungon ndriçimi ndalohet puna.
10. Ndalohet qendrimi dhe kalimi i punonjesve brenda rrezes se veprimit te mjeteve ngarkuese dhe transportuese, kur ato jane duke punuar.
11. Ndalohet riparimi i avarive, grasatimi dhe punime te tjera kur makinerite jane ne levizje.
12. Para se te fillohet nga puna behet kontrolli i frontit te punes, gjendja teknike e makinerive etj.

Detyrimet e punemarresit: Detyrimet kryesore jane:

1. Te njoh rregulloren e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te leshuar nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punes dhe ti zbatoje ato ne pune.
2. Te dije mire shkaqet e mundshme te aksidenteve per çdo proces pune.
3. Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne zbatim.
4. Kur konstaton shenja te nje avarie te mundshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare te marre masa per eliminimin e saj, nderkohe lajmeron gjithë punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin teknik.
5. Te perdoren mjetet e mbrojtjes individuale ne pune si: kapele, rrobat me çizme pune, doreza, maskat e mbrojtjes nga pluhuri, gazrat dhe tapa veshi per zhurmat, uniforme te vecanta etj.
6. Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte.

Menaxhimi i lëndëve të para

Sistemi i transportit

Transportimi i lëndëve të para, të cilat luajnë një rol kyç për operimin normal dhe brenda normave të sigurimit teknik, të proceseve që realizohen në objektin ku është instaluar impianti për prodhimin e produkteve te betonit. Transporti sigurohet nga mjetet e shoqërisë "KËLLIÇI-2009" SHPK, te cilat jane ne gjendje shum te mire funksionale. Furnizimi me lëndë të pare bëhet periodikisht sipas kërkesave dhe funksionimit të impiantit. Mjetet e transportit janë të kolauduara dhe të mbuluara, me qëllim shmangien e rrezikut për humbje apo demtim të lëndës së pare dhe produkteve gjatë transportit dhe mbrojtjen e mjedisit. Shpejtësia e lëvizjes së mjeteve është brenda rregulloreve dhe kriterëve të transportit të materialeve, në varësi të materialit që transporton.

Dorëzimi i lëndëve të para

Mjetet e transportit regjistrohen para hyrjes në territorin e objektit. Bëhet verifikimi i materialit që transportohet brenda tyre, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë dhe drejtuesi teknik i operacioneve brenda ne objektin e "KËLLIÇI-2009" SHPK nëse ka mospërputhje të lëndëve te para që janë porositur dhe lëndëve që kan ardhur në objekt.

Mjetet e transportit parkohen brenda objektit në vendin e caktuar prej shoqërisë, duke ruajtur të gjitha distancat dhe masat e sigurisë, për operimin normal të punës për shkarkimin e ngarkesës. Shkarkimi i lëndëve të para realizohet nga vete automjetet respektivisht ne impiantet perkates (depozitata e lendes se pare), nën kujdesin e vecantë të drejtuesit teknik dhe masa të mëdha sigurie në varësi të lëndës së pare. Pas shkarkimit të materialit, bëhet edhe një here verifikimi i sasisë së marrë në dorëzim, nëse kemi humbje apo rrjedhje të lëndës së pare. Drejtuesi teknik sigurohet që ambienti i depozitave te inerteve, sillosin e cimentos jane te sigurta, për ruajtjen ne kushtet e kerkuara dhe lageshtise te lendes se pare te depozituar..

Magazina

Depozita e inerteve dhe sillosat e cimentos qe sherbejne per depozitimn e lendes se pare te nevojshme per vendosjen ne pune te impiantit per prodhimin e produkteve te betonit jane ne gjendje shume te mire, te kolauduara nga inxhieneret e fushes dhe te lyera me boje antikorrodive ndaj kushteve atmosferike dhe agjenteve gerryes te lendes se pare qe depozitohet ne to.

Bazamenti mbi të cilin janë vendosur depozitat e lëndës së parë është projektuar i tillë që mos të kemi erozion, vibrime apo avari të ndryshme gjatë depozitimit dhe funksionimit të linjes së instalimit.

Magazina (Kontajner) do të shërbejë për magazinimin e lëndëve të para plotësuese, pajisjeve/aparaturave ndihmëse dhe pjesëve të këmbimit për impiantin/makinerite. Struktura arkitektonike e magazines i plotësojnë të gjitha kushtet tekniko-inxhinierike për magazinimin e sigurtë të lëndëve të para me hapësira të bollshme dhe ndricimin e duhur, sipas normave të sigurimit teknik, në varësi të lëndëve të para plotësuese që magazinohen.

Transporti i brëndshëm

Transporti i brëndshëm i lëndëve të para dhe produkteve të përfunduara realizohet nga punonjësit dhe mjetet e shoqërisë, të cilët janë të veshur me pajisjet e posaçme për llojet e materialit që transportojnë. Në varësi të distancës së transportit nga vendi i magazinimit në impiantin e prodhimit, përdoren e mjetete të posaçme që drejtohen nga punonjësit e firmës, nën kujdesin e drejtuesit teknik, i cili monitoron dhe drejton funksionimin e operacioneve dhe proceseve për shfrytëzimin sa më eficient të lëndës së parë (inerte) dhe instalimit me qëllim arritjen e produkti përfundimtar sipas kërkesave të klienteve dhe standarteve të kërkuara për të tilla procese pune.

Organizimi i punës dhe fuqia punëtore

Puna brenda në objekt është e ndarë qartë, dhe secili prej punonjësve realizon ato procese pune për të cilat ai është ngarkuar nga përfaqësuesi i shoqërisë, procesi i prodhimit është i automatizuar dhe monitorohet nga drejtuesit teknik i linjes së prodhimit të produkteve të betonit.

Në të punojnë rreth 8 punonjës, në varësi të kërkesave për produktet e betonit nga shoqëria dhe klienti të ndryshëm.

Regjimi i punës do të jetë me 1 turn kur shoqëria do të punojë me kapacitet të plotë. Punonjësit e punësuar kanë eksperiencë shumë vjetare në kryerjen e proceseve të ndryshme të prodhimit të blloqeve, tubave dhe bordurave prej betoni.

Për Menaxhimin e materialeve dhe funksionimin e linjes së prodhimit të betonit në një ditë të zakonshme pune, skema e funksionimit është shumë e thjeshtë dhe e mirë organizuar nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë "KËLLIÇI-2009" SHPK, Ecuria e punës është si më poshtë:

- *Drejtuesit teknik menaxhojnë plotësisht të gjithë rrethin e punës së impiantit të prodhimit të produkteve të Betonit, duke filluar nga regjistrimi i urdhrave të përditshme, listën e procesimit të kërkesës, llogaritjen e prodhimit, në përputhje me agregatet që do të përdoret dhe sa metra kub do të prodhohen, sasinë e kërkuara të lëndëve të para, menaxhon kohët e dorëzimit dhe shkarkimit, kompenson dhe përmirëson gabimet e prodhimit duke përdorur një sistem vetë-korrigjimi.*
 - Kontrollon në kohë reale ecurinë e variablave të prodhimit dhe paraqet në grafik vizual prodhimin në orë.
 - Kontrollon dhe kordinon plotësisht proceset e prodhimit (*dozimin dhe peshat e materialeve të lëngëta dhe ngurta*) dhe ofron informacione të vazhdueshme të konsumit.
- Lejon një gamë të gjerë të programeve të prodhimit nëpërmjet menaxhimit dhe trajtimit të operacioneve, të tilla si:
 - Menaxhimin e Porosive

- Skedimin dhe menaxhimin e dokumenteve të shpërndarjes, me një rend automatik të printimit në fund të procesit të ngarkimit të mikserit.
- Dokumentet menaxhimin të shpërndarjes madje edhe për ngarkimin manual.
- Menaxhimin e lëndës së parë, kur hyjnë dhe dalin
- Menaxhimin e përditshëm të prodhimit
- Programet e mirëmbajtjes së makinerive
- Ruan një skedar të operacioneve të Impiantit të prodhimit të produkteve të Betonit
- Kontrollon parametrat për shfrytëzimin më të mirë të aftësive të linjes së prodhimit.

Drejtuesi i Panelit të Kontrollit

- Automatikisht (*duke përdorur sensorë*) ose manualisht kundër balancon ujin për lagështirën e agregateve
 - Në rast të mungesës, ajo përcjell lëndë të para alternative për përdorim.
 - Parashikon dhe llogarit avancën e ujit dhe kundër balancon atë me ujë përbërës.
 - Menaxhon sekuenat e ngarkimit, për çdo përbërje, rregullon rrugën hyrëse të materialeve, kohën e përzierjes dhe shkarkimit.
 - Kontrollon kohën reale për çdo fazë funksionimi dhe optimizon kohët e prodhimit, konsumit të energjisë dhe të lëndëve të para.
 - Automatikisht ndan sasinë e kërkuar të ngarkimit, bazuar në aftësitë e impiantit të prodhimit.
 - Matje e dozimit me shpejtësi dyfishë të të gjitha materialeve, për peshim të shpejtë dhe saktësi absolute.
 - Menaxhon matje dozimi të njëkohshme të materialeve të njëjtë për përmirësimin e kohës nxjerrjes.
- Drejtuesi Teknik kontrollon rezervat materiale dhe njofton për ato që ka më pak në magazinë.
 - Drejtuesi i Panelit të Kontrollit automatikisht informon bazën e të dhënave për lëvizjen e materialeve në mënyrë manuale apo automatike.
 - Automatikisht arkivon proceset ditore (konsumi në mënyrë automatike apo manuale, metrat kub të prodhimit për çdo recetë, etj)
 - Menaxhon kartat mirëmbajtjes së të gjitha automjeteve dhe makinerive të kantierit, të bazuar në metër kub apo periudhë kohore
 - Drejtuesi i Panelit të Kontrollit rregjistron manualisht lëvizjet e panelit të operimit.
 - Menaxhon historikun duke iu referuar alarmeve, duke i dhënë mundësinë të kategorizojë dhe printojë
 - Drejtuesi Teknik menaxhon pjesën e depozitimit të materialeve dhe rezervave
 - Punonjesit
 - Drejtojnë operacionet e ngarkim-shkarkimit të lëndës së parë
 - Mirëmbajnë, kontrollin dhe riparimin e linjes së instalimit/aparaturave
 - Rakordimi i sasisë së materialit të shkarkuar dhe produktit perfundimtar
 - Magazinimin dhe transportimin e lëndëve të para
 - Drejtimin e makinerisë së prodhimit të blloqeve
 - Montojnë dhe cmontojnë kallepet e prodhimit të tubave
 - Drejtojnë operacionet për vibrimin e tubave me qëllim rritjen e rezistencës së materialit të prodhuar.
 - Menaxhojnë procesin e tharjes së produkteve duke bërë sperkatjen e vazhdueshme të tyre me ujë.
 - Bëjnë ambalazhimin e produktit dhe ngarkimin e tij për transportimin e tyre drejt klienteve.

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve

Aktiviteti që zhvillon shoqëria "KËLLIÇI-2009" SHPK, Tirane Helmes HELMES Helmes, Shtodher, objekt 1 katesh, zone kadastrale nr 3427, nr pasurie 44/9, nga proceset e ndryshme të operimit të punës në objekt për prodhimin e produkteve të betonit gjenerohet një sasi mbetjesh.

Rrymat prioritare të mbetjeve të gjeneruara në objekt dhe nga linja e impiantit të betonit, ndahen sipas fraksioneve të mëposhtme:

- ❖ Mbetje inerte
- ❖ Mbetje të ngurta urbane (Mbetjet të ambalazhit, karton, plastik, kanaçe, etj)

Qëllimi i menaxhimit të mbetjeve: Diferencimi i mbetjeve të gjeneruar brenda objektit të shfrytëzuar, sipas fraksioneve kryesore nëpërmjet instalimit të sistemit me 3-Kontenier, reduktimin e mbetjeve inerte, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve inerte dhe transportimi periodik të mbetjeve urbane në vendin e caktuar nga njësi vendore, përmes bashkëpunimit me NJQV-në (Komunen) për firmat e kontraktuara në grumbullimin e mbetjeve urbane, në ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme në diferencimin e mbetjeve.

Menaxhimi i mbetjeve brenda zones së instalimit është tërësisht i bazuar në SKMM, PKMM, PRMM dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve.

Objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të planit janë si më poshtë:

- Instalimi i sistemit me 3-kontenier brenda zones ku zhvillohet aktiviteti
- Diferencimi i mbetjeve, sipas tre rrymave prioritare (Plastik, Letër/Karton dhe Mbetje të tjera).
- Rikuperimi, Riciklimi dhe Riperdorimi në maksimum të mbetjeve inerte, duke rritur efikasitetin e vete impiantit dhe reduktimin e kostos për asgjësimin e tyre.
- Transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendepozitimin e caktuar nga Njësia Vendore.
- Nënshkrimi i kontratave me biznesin e riciklimit për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane që gjenerohen nga aktiviteti

Synimet:

- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e objektit dhe diferencimin e mbetjeve sipas tre rrymave kryesore.
- Organizimi i diferencuar i mbetjeve në përputhje me politikën kombëtare, për të mundësuar dhe stimuluar metodat e trajtimit të mbetjeve (riciklimi dhe riperdorim).
- Planifikimi dhe ngritja në nivelin zonal i një rrjeti të kontenierëve për diferencimin e mbetjeve me qëllim për të maksimizuar dobinë e Landfillit të Durrës.
- Maksimizimi i përdorimit të mbetjeve urbane
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe trajnimi i punonjësve të vetë shoqërisë, duke ofruar një efikasitet dhe efektivitet në diferencimin dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Mbrojtjen e Mjedisit nga mbetjet e ndotura urbane, duke maksimizuar dobinë e tyre dhe reduktimin e CO2 në atmosferë.
- Asgjësimin perfundimtar dhe maksiminimin e përdorimit të mbetjeve inerte.
- Diferencimi i mbetjeve në tre fraksione kryesore të mbetjeve:
 - 1- Plastike dhe Polietilene
 - 2- Letër/Karton
 - 3- Të thata dhe të kompostueshme

Mbetje inerte 2% e sasisë totale të prodhuar e cila rifutet në proces perseri.

Mbetjet e ngurta

Mbetjet e ngurta vijne nga: Aktiviteti human, mbetje urbane te plastikes, qelqit, metaleve etj te cilat jane te riciklueshme dhe do te hidhen ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones.

Mbetjet inerte qe gjenerohen gjate procesit te prodhimit jane ne sasi te vogla dhe ato grumbullohen dhe riperdoren perseri ne impiantin e prodhimit te produkteve te betonit, ndersa ajo sasi e betonit e cila vjen nga rrjedhjet qe mund te gjenerohen nga makineria e prodhimit te blloqeve perdoret per shtrim e hapsirave te pashtuara ne sheshin ne krah te impiantit.

- **Masat zbutese te projektuara te ndikimeve negative gjate procesit te funksionimit**

Masat zbutëse të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjatë punimeve në ajër, si pluhurat dhe zhurma, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore në territor , faun dhe florë. Por pikësynimi i studimit mbetet menaxhimi i linjës së prodhimit dhe evitimi në maksimum i klirimit të pluhurave (grimcat PM10) në ajer dhe ujrave teknologjik.

Identifikimi i masave për të eliminuar apo zbutur ndikimet negative në mjedis

- Planifikimi i zones së instalimit

Për shmangien dhe parandalimin e gjenerimit të grimcave të pluhurit dhe zhurmave, si dhe për ruajtjen e regjimit të linjës së prodhimit dhe prametrave inxhiniero mekanike të saj, në projekt është përcaktuar funksionimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë i objektit në tërësi dhe i linjës së prodhimit të produkteve të betonit.

Në objektin ku ndodhet instalimi është parashikuar hapa pas hapi, rigjenerimi i mjedisit të brendshëm e të jashtëm, sistemimi i lëndës së pare, parkimi i automjeteve, magazinimi i pajisjeve/makinerive ndihmese dhe ngarkimi produktit të prodhuar blloqe, tuba, pllaka, bordura, duke realizuar shfrytëzimin sa më eficient të mjedisit të shfrytëzuar nga shoqëria "KELLIÇI-2009" SHPK Përgjate perimetrit te zones ku eshte instaluar impianti i betonit eshte mbjelle kurore pemesh te gjelberta te reja me lartesi 1 m dhe me distance na njera tjetra prej 3 m. Kjo sipërfaqe e përfutur nga trajtimet e mësipërme, do të japë mundësi për rikultivimin e bimëve dhe pemëve të ndryshme, duke krijuar njëherësh kushte për parandalimin e emetimit të grimcave të pluhurit, kapjen e ndotesve atmosferik dhe përmisimin e pamjes së përgjithshme të mjedisit të zonës në shfrytëzim.

Duhet theksuar se sipërfaqja e objektit në shfrytëzim nga firma "KELLIÇI-2009" SHPK është relativisht e vogël dhe nuk përbën ndonjë ndikim në zone. Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim

- Përdorimi i tokës: Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
- Mbrojtja nga erozioni: Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së impiantit të prodhimit. Ndërtimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku janë të instaluar linja e prodhimit të produkteve të betonit.
- Demtimi potencial i vegjetacionit: Mirembajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidanëve të rinj, përgjate rruges që ben të mundur hyrjen për në objekt.
- Cilesia e ajrit: Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburanti cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrim periodik i linjës së impiantit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij. Sperkatja periodike e sheshit.
- Sistemi i drenazhimit: Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave

teknologjike te pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një vaske dekantimi të përbashkët, ku më pas do të realizohet shkarkimi në kolektorin kryesorë të kanalizimeve të zones.

- Mbetjet: Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia vendore. Asgjesimi i mbetjeve që vijnë nga impianti, nga kompani te licensuara. Rikuperim, Riciklim dhe Ripërdorim ne maksimum i mbetjeve inerte.
- Ujrat e ndotura urbane: Trajtimi i ujrave te perdorura teknologjike, duke i deguar ne vasken e dekantimit dhe me pas shkarkimi i tyre ne kolektorin kryesor te zones. Lidhja me sistemin e kanalizimeve të zonës. Minimizimi i konsumit të ujit.
- Zhurmat: Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i linjës së prodhimit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.

Masat lehtësuese që do të ndermerren gjatë funksionimit të linjes së prodhimit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese. Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga shoqëria për funksionimin e impiantit. Ndikimet negative në mjedis gjatë funksionimit të linjes së prodhimit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë permendur në mënyrë të përmbledhur si më poshtë :

- Menaxhimi optimal dhe mirembajtja e linjes së prodhimit.
- Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen ne objekt të depozitohen në vëndet e përcaktuara nga Njësia Vendore dhe të vendosen kontenier te mjaftueshem për mbetjet për numrin e punonjësve.
- Rikuperimi, Riciklimi dhe Ripërdorimi i mbetjeve inerte
- Kapja e grimcave te pluhurit nepermjet sprucimit te ujit
- Menaxhimi sa me eficient i lendes se pare.
- Mirembajtja nderrimi periodik i filtrave sipas kapacitetit mbajtes se tyre.
- Të respektohen oraret e operimit të punës brenda mjedisit ku zhvillohet aktiviteti për prodhimin e produkteve të betonit.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.

• Programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për impiantin e prodhimit të produkteve të betonit është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me instalime për prodhimin e produkteve të betonit, i pozicionuar ne **Tirane - Helmes, Shtodher, objekt 1 katesh, zone kadastrale nr 3427, nr pasurie 44/9**, nevojitet një

monitorimi vazhdueshëm, jovetëmnë linjen e prodhimit dhe makinerite, por dhe në një zonë mbi 50m për rreth linjes së prodhimit.

ADMINISTRATORI
Altin Këlliçi

